

KOSOVO POLICE

MBROJTËSI

Vëllimi IX - Nr. 12 / 2022

... drejtësi për të gjithë



SFIDË DHE HEROIZËM

EDITORIAL

Policia gjatë rrugëtimit të saj përgjatë viteve, përveç të të arriturave dhe sukseseve, ka pasur edhe vështirësi dhe sfida.

Duke marrë për bazë kohën dhe rrethanat nëpër të cilat gjendej vendi ynë gjatë viteve 99, rruga për themelimin e Policisë së Kosovës nuk ka qenë e lehtë, e duke përshkruar nëpër vite do të theksojmë se për këto 23 vjet Policia ka kaluar nëpër sfida të ndryshme të cilat ka arritur t'i kalojë me sukses.

Ndërtimit të Policisë së Kosovës si një polici shumetnike dhe demokratike me orientim drejt komunitetit në frymën e institucioneve përfaqësuese, llogaridhënëse dhe demokratike i ka paraprirë bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtar dhe vet përkushtimi, vullneti e dëshira e zyrtarëve policorë për t'i shërbyer vendit dhe qytetarëve pa dallime.

Policia e Kosovës tani më është duke dëshmuar zotimin e saj për të vërtetuar rolin e saj si një polici demokratike e bazuar në komunitet, që ekziston në modelet më të mira të policimit në Evropë e më gjerë, ku performanca e zyrtarëve të Policisë së Kosovës lirisht mund të themi se krahasohet me performancën e policive të shteteve më të zhvilluara demokratike.

Puna dhe përkushtimi i pandalshëm në ofrimin e sigurisë, ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike si dhe luftën ndaj krimit, ka bërë që Policia e Kosovës të fitojë besimin e qytetarëve, e të rangojë Policinë si një nga institucionet më të besueshme në vend dhe të vlerësuar edhe nga mekanizma ndërkombëtar si një histori suksesi.

Falë angazhimit, punës dhe sakrificës për t'i shërbyer vendit dhe qytetarëve, zyrtarët e Policisë së Kosovës, duke mos kursyer as jetën e tyre, vazhduan synimet dhe vizionin e Policisë drejt përmbushjes së strategjisë së vet të zhvillimit, në përputhje me kërkesat e vendit dhe qytetarëve të Kosovës, ku për këto 23 vite pune, sfida dhe heroizmi, 22 prej tyre dhanë atë më sublimen, dhanë jetën e tyre për vendin.

Shteti i Kosovës, në shenjë nderimi dhe përkujtimi të 22 zyrtarëve të rënë në kryerje të detyrës, i dekoroj me titullin Heronj të Kosovës. Heronjtë e Kosovës do të mbahen mend në historinë më të re të shtetit të Kosovës për guximin, dashurinë, përkushtimin dhe vullnetin për ndërtimin e shtetit demokratik, shtetit në të cilin betohen të gjithë për sundim të rendit dhe ligjit. Ata ranë në krye të detyrës së shenjtë të zbatuesit të ligjit, në betejë për të ruajtur rendin kushtetues dhe për të zbatuar ligjin në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

**Baki KELANI**

Revistë e Policisë së Kosovës

Botues:

ZIMP

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie
me Publikun e PK-së
DPP - Prishtinë

Kryeredaktor:

Baki KELANI

Redaktor:

Daut HOXHA

Menaxhimi i dizajnit dhe grafikes:

Çajup KAJTAZI

Lektor:

Leonora FEJZULLAHU - RUHANI

Fotograf:

Arbër MUHADRI

Bashkëpunëtorë:

Luljeta Mehmeti-Quigley
Çajup Kajtazi
Merita Canolli – Gashi
Arlinda Rexhepi – Gërzhaliu
Arben Gashi

Tel:

Tel.: 038 5080 1243
Tel.: 038 5080 1237
Mob.: 044 506 308
Mob.: 044 181 418

E-mail:

baki.kelani@kosovopolic.com
daut.hoxha@kosovopolic.com
zimp@kosovopolic.com

Telefon: 192

info@kosovopolic.com
www.kosovopolic.com
facebook.com/KosovoPolice



PËRMBAJTJA

4| Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm, Kolonel Fehmi Hoti, ka zhvilluar një takim zyrtar me Atasheun e Programit të Departamentit të Drejtësisë të Ambasadës Amerikane, Kimberly Riffe

4| Ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm z. Fehmi HOTI, priti në një takim zyrtar Ambasadorin Michael DAVENPORT

5| U.d. drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Fehmi Hoti u shënuar në librin e zisë për mbretëreshën Elizabeth II

5| Zëvendës drejtori i Përgjithshëm për resurse në PK, z. Dejan Jankovic, priti një delegacioni nga Ministria e Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut

6-7| Policia e Kosovës festoi 23 vjetorin e themelimit të saj

8-9| Ceremonia përkujtimore e 22 Heronjëve të Kosovës

10| Policia e Kosovës dhe Ministria e

Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me përkrahjen e OSBE-së bashkëpunojnë për adresimin e shqetësimeve të sigurisë në shkolla

11| Ambasada e Zvicrës jep donacion me pajisje biometrike për Policinë Kufitare të Kosovës

12| Ekipi i Policisë së Kosovës, fiton turneun e futballit 'copa del mare' të mbajtur në Itali

13| Aplikacioni "VOICE App" në shqip, serbisht dhe anglisht lehtëson komunikimin dhe fuqizon bashkëpunimin me qytetarë

13| Kadetët policorë të gjeneratës 57-të, nënshkruajnë kontratën e punës, fillojnë trajnimin themelor në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike

14| 20 vjet polic i Kosovës, 14

15| Trajtime të rëndësishme për zhvillimin e kapaciteteve policore, ngritjen e njohurive dhe aftësive mbi kategorizimin e armëve, eksplozivëve dhe prekursorëve të tyre

16| Bashkëpunimi ndërmjet akterve vendor dhe ndërkombëtar, OJQ-ve dhe qytetarëve, në iniciimin e strategjisë për marrëdhënie me publikun

17| Fëmijët e ardhmja e Policisë së Kosovës

18| Njësitet elite të Policisë së Kosovës, çdo ditë e më të forta dhe më profesionale

19| UNDP-ja me donacion për Policinë e Kosovës, ndihmesë për kontroll më të mirë të armëve

20-21| 'Veprimi i shpejtë'- Ushtrim i përbashkët fushor i Policisë së Kosovës dhe EULEX-it

22-23| Operacione

24-25| Policia e Kosovës, vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, 24-25

26| Siguria në shkolla ndër angazhimet kryesore të Policisë së Kosovës

27| Kuriozitete



PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të disa shkrimeve të këtij botimi nuk paraqesin medeomos qëndrimet ose vështrimet zyrtare të PK-së.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Përgjithshëm, kolonel Fehmi Hoti, ka zhvilluar një takim zyrtar me Atasheun e Programit të Departamentit të Drejtësisë të Ambasadës Amerikane, Kimberly Riffe



Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Përgjithshëm, kolonel Fehmi Hoti, në zyrën e tij në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë në Prishtinë, ka zhvilluar një takim zyrtar me Atasheun e Programit të Departamentit të Drejtësisë të Ambasadës Amerikane, Kimberly Riffe dhe Këshilltaren vendore të ICITAP-it, Leonora Berkani. Diskutimet përfshinin

partneritetin e vazhdueshëm strategjik të DOJ/ICITAP dhe Policisë së Kosovës për avancimin e praktikave efektive për zbatim të ligjit dhe parimet e forta të sundimit të ligjit në polici. Atasheu Riffe është zotuar se do të vazhdojë të ofrojë ndihmë që avancojnë profesionalizimin e Policisë dhe siguron që angazhimi qytetar/polici të jetë prioritet. Drejtori i

Përgjithshëm Hoti u përgjigj me zotimin e tij për vazhdimin e partneritetit me ICITAP-in dhe agjencitë e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara dhe vlerëson mbështetjen në të kaluarën dhe në të ardhmen. Të dy konfirmuan vazhdimin e marrëdhënieve prej disa dekadash në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës.

Ushtruesi i detyrës së drejtorit të Përgjithshëm z. Fehmi HOTI, priti në një takim zyrtar Ambasadorin Michael DAVENPORT

Në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, ushtruesi i detyrës së drejtorit të Përgjithshëm z. Fehmi HOTI, priti në një takim zyrtar Ambasadorin Michael DAVENPORT, kryesues i Misionit të OSBE-së në Kosovë. Takimi kishte karakter bashkëpunues, si dhe forcimin e partneritetit të mëtejshëm ndërmjet OSBE-së dhe Policisë së Kosovës. Bashkëpunimi reciprok dhe ndihma e vazhdueshme e OSBE-së për Policinë e Kosovës u vlerësua lart duke konfirmuar avancimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.





U.d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Fehmi Hoti, u shënua në librin e zisë për mbretëreshën Elizabeth II

Në hapësirat e Ambasadës së Britanisë së Madhe në Prishtinë, u. d. drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Fehmi Hoti, u shënua në librin e zisë me rastin e vdekjes së mbretëreshës Elizabeth II.

“E nderuara familje mbretërore e Mbretërisë së Bashkuar, e respektuara Ambasadë Britaneze në Prishtinë, në emër të Policisë së Kosovës dhe në emrin tim personal ju shprehim ngushëllimet më të sinqerta me rastin e vdekjes së Mbretëreshës Elizabeth II. Zoti e bekoftë popullin e Mbretërisë së Bashkuar”.
U prehsh në paqe, Madhëria juaj!

Partneriteti i Policisë së Kosovës me KFOR-in, garanci për sigurinë e përgjithshme në vend

Në takimin e realizuar ndërmjet z. Fehmi Hoti, u. d. drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës dhe komandantit të KFOR-it, z. Ferenc Kajari, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës në Prishtinë, u diskutuan tema të rëndësishme për sigurinë dhe bashkëpunimin e mëtutjeshëm në fushat me interes të përbashkët. Mbështetja e KFOR-it ndaj Policisë së Kosovës që nga themelimi i saj e deri më tani vlerësohet kruciale. Sfidat që ka pasur vendi dhe Policia në veçanti janë përballuar me sukses falë bashkëpunimit dhe partneritetit që ka ekzistuar ndërmjet Policisë së



Kosovës me KFOR-in.

Me rastin e takimit të dy krerëve më të lartë të këtyre dy institucioneve të sigurisë u rikonfirmuar se bashkëpunimi dhe partneriteti do të avancohet edhe më tej në funksion të garantimit të sigurisë së përgjithshme për të gjithë qytetarët e vendit pa dallim.

Zëvendës drejtori i Përgjithshëm për resurse në PK, z. Dejan Jankovic, priti një delegacioni nga Ministria e Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut



Zëvendës drejtori i Përgjithshëm për resurse në PK, z. Dejan Jankovic me stafin menaxherial, priti një delegacioni nga Ministria e Brendshme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, zyrtarë të lartë nga Departamenti për Bashkimin Evropian dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar në kuadër të MB-së, si dhe përfaqësues nga misioni i OSBE-së në Shkup dhe Kosovë.

Qëllim i kësaj vizite është njoftimi mbi projektin e OSBE-së për dygjuhësi që ka filluar të implementohet nga Policia e Kosovës, projekt ky i dedikuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë dhe financuar nga qeveria zvicerane.

Në takim po ashtu u diskutuan tema të tjera relevante me interes reciprok.



POLICIA E KOSOVËS FESTOI 23 VJETORIN E THEMELIMIT TË SAJ



Policia e Kosovës, përmes një ceremonie festive shënoi 23 vjetorin e themelimit të saj, në të cilën morën pjesë personalitetet më të larta shtetërore, presidentja Vjosa Osmani- Sadriu, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, ministri i Punëve të Brendshme z. Sveçla, u. d. drejtori i Përgjithshëm i PK-së z. Hoti, përfaqësues të inistucioneve vendore dhe partnerë ndërkombëtarë si dhe menaxhmenti i lartë i PK-së. Me rastin e shënimit të 23 vjetorit, Policia e Kosovës, për pjesëtarët e saj, për punën e dalluar policore, ka ndarë medalje, mirënjohje dhe lëvdata, të cilat janë shpërndarë në departamente dhe drejtoritë rajonale. Po ashtu në shenjë falënderimi për bashkëpunim me PK-në mirënjohje u janë ndarë edhe qytetarëve.





CEREMONIA PËRKUJTIMORE



Përgatiti: Arlinda Rexhepi - Gërzhaliu

Policia e Kosovës, për vite me radhë është duke dëshmuar zotimin e saj për të vërtetuar rolin e një policie demokratike, e bazuar në komunitet, që për këto vite falë edhe përkrahjes së institucioneve shtetërore dhe qytetare, është zhvilluar dhe avancuar si institucion, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë logjistik, e burime njerëzore.

Deri më tani Policia e Kosovës numëron mbi 8000 zyrtarë policorë të uniformuar,

ku nga ta Policia e Kosovës e ka për privilegj që pjesë e saj ishin edhe 'zyrtarët policorë të rënë në kryerje të detyrës' e që sot të gjithë i njohin si 22 heronjtë e Kosovës.

Pikërisht ata janë argumenti më i mirë se zyrtari policor ka detyrë aq humane, saqë kundrejt çdo sfide, duke vënë përballë rrezikut edhe jetën e tij, realizon betimin e dhënë që me fillim bartjen e uniformës.

Vepra e çmuar e këtyre pjesëtarëve të Policisë frymëzon edhe shumë të tjerë për përmbushjen e detyrave me dinjitet dhe profesionalizëm të lartë.

Pikërisht për nder të veprës së tyre, me datën 26 korrik 2022 Policia e Kosovës organizoi një ceremoni përkujtimore e cila filloi me një minutë heshtje dhe vijoi me fjalime nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, ministri i Punëve të Brendshme si dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, të cilët çuan në pedestal veprën e tyre.

Në ceremoni, në shenjë respekti për zyrtarët policorë të rënë në kryerje të detyrës po ashtu parakaluan edhe Garda e Nderit, fëmijët e uniformuar dhe njësi të ndryshme policore që

u duartrokitën dhe u përcollën nga personalitete vendore, ndërkombëtare si edhe nga qytetarë që kishin ardhur për ta përcjellë nga afër ceremoninë.

Lista e zyrtarëve policorë të rënë në detyrë - 22 heronjtë e Kosovës përbëhet nga:

1. Lazim Rexhepi
2. Danush Hasani
3. Hajdar Ahmeti
4. Sabahate Tolaj
5. Isuf Haklaj
6. Arsim Rrustolli
7. Ilir Llapatinca
8. Driton Mehana
9. Abedin Mustafa
10. Avni Kasumi
11. Triumf Riza
12. Slavisa Milovanovic
13. Misin Krasniqi
14. Enver Zymberi
15. Jahi Maliqi
16. Nebih Ramadani
17. Shemsi Gashi
18. Armend Trena
19. Malsor Dashi
20. Izet Demaj
21. Sami Thaqi
22. Arben Sejdiu



E 22 HERONJVE TË KOSOVËS



Aktualitet

Policia e Kosovës dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, me përkrahjen e OSBE-së, bashkëpunojnë për adresimin e shqetësimeve të sigurisë në shkolla

Policia e Kosovës në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe me përkrahjen e OSBE-së, misioni në Kosovë, me 15 qershor 2022, realizuan punëtorinë prezantim të metodologjisë së hulumtimit për sigurinë në shkollat e ciklit parauniversitar në nivel vendi. Qëllimi i këtij hulumtimi është identifikimi i shqetësimeve rreth sigurisë në shkolla dhe orientimi i politikave të përbashkëta në drejtim të parandalimit afatgjatë të dukurive negative dhe shqetësimeve tjera të sigurisë në shkolla të ciklit parauniversitar. Hulumtimi do të fillojë të realizohet në fillim të vitit të ri shkollor 2022-2023.



Ambasada e Zvicrës jep donacion me pajisje biometrike për Policinë Kufitare të Kosovës



Policia e Kosovës në një ceremoni të organizuar në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme, ka pranuar një donacion nga Ambasada e Zvicrës me pajisje biometrike për Policinë Kufitare. Pranim-dorëzimi i këtij donacioni u nënshkrua nga drejtori i Departamentit për Kufitare, Ragip Bunjaku si dhe znj. Eva Kitzler, shefe e ICPMD për Ballkan.



EKIPI I POLICISË SË KOSOVËS, FITON TURNEUN E FUTSALIT 'COPA DEL MARE' TË MBAJTUR NË ITALI

Në Itali është organizuar një turne në futsal, ku kanë marrë pjesë 28 ekipe nga 14 shtete. Ekipet e fustalit kanë qenë ekipe të agjencive të sigurisë së shteteve përkatëse. Në këtë turne ka marrë pjesë edhe një ekip i fustalit nga Policia e Kosovës.

Ekipi i Policisë së Kosovës ka zhvilluar nëntë takime, ku tetë nga këto takime i ka fituar. Ekipi i PK-së ka zhvilluar lojërat në këtë renditje, me këta kundërshtarë dhe janë shënuar këto rezultate:

Dita 1:

Policia e Kosovës - Baraberi (Sllovaki) 2:4

Policia e Kosovës - Torri (Itali) 5:1

Policia e Kosovës - Caracal PD (Romani) 7:1

Policia e Kosovës - Unidas (USA) 14:1

Dita 2:

Policia e Kosovës - Flemalle (Belgjikë) 9:1

Policia e Kosovës - Marseille (Francë) 12:1

Dita 3:

Çerekfinale

Policia e Kosovës : IPA Olsztyn (Poloni) 2:1

Gjysmëfinale

Policia e Kosovës - Bologna (Itali) 3:0

Finale

Policia e Kosovës - Bratislava (Sllovaki) 2:1

Pra, ekipi i fustalit i PK-së është shpallur fitues, duke marrë edhe kupën e turneut. Ekipi i PK-së ka arritur rezultate të shumta edhe në turne të mëhershëm, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Në këtë turne, ekipi përbëhej nga zyrtarët policorë (lojtarët): Kreshnik Haliti, Gani Konjuhi, Qëndrim Berisha, Ardit Hyseni, Mentor Krasniqi, Sami Geci, Driton Dauti, Egzon Abazi, Bledar Mamusha, Besart Berisha, Faton Shala - staf teknik dhe Amir Gërguri-selektor.



Aplikacioni “VOICE App” në shqip, serbisht dhe anglisht lehtëson komunikimin dhe fuqizon bashkëpunimin me qytetarë

Policia e Kosovës me përkrahjen e OSBE-së, (misioni në Kosovë) dhe qeverisë zvicerane/Ambasadën e Republikës së Zvicrës në Kosovë, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Komisionierit për Gjuhë- në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, ka zhvilluar dhe ka përgatitur për zyrtarët e saj një aplikacion për telefon celularë, të quajtur “VOICE App” në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht si dhe doracakun dygjuhësorë, mjete këto, të cilat do ta lehtësojnë komunikimin me qytetarët kurdo që është e nevojshme si dhe do t’i mundësojnë Policisë së Kosovës të fuqizojë bashkëpunimin me qytetarë edhe më tutje.

Qëllimi i lansimit të këtij aplikacioni është lehtësimi i kontaktit të përditshëm mes qytetarëve dhe zyrtarëve të Policisë së Kosovës, gjë që tregon për përkushtimin e vazhdueshëm të Policisë së Kosovës në respektim dhe zbatim të të drejtave të njeriut si dhe përmbushjen



e vizionit të Policisë së Kosovës dhe menaxhmentit të lartë për krijimin e një ambienti të sigurt si dhe zbatimin e ligjeve të aplikueshme për qytetarët të cilëve iu shërben.

Komunikimi është bazë për krijimin e lidhjeve të forta me komunitetin dhe forcimin e besimit të ndërsjellë dhe

partneritetit me qytetarë.

Policia e Kosovës është e përkushtuar të zhvillojë projekte të cilat përmes komunikimit efektiv me qytetarët e Kosovës mundësojnë ofrimin e shërbimeve kualitative si dhe fuqizojnë bashkëpunimin dhe partneritetin me komunitetin.

Kadetët policorë të gjeneratës 57-të, nënshkruajnë kontratën e punës, fillojnë trajnimin themelor në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike

Pas përfundimit të procesit të rekrutimit dhe seleksionimit Policia e Kosovës, me 6 dhe 7 korrik 2022 bëri nënshkrimin e kontratave të marrëdhënies së punës për kadetë policorë për gjeneratën e 57-të të PK-së, të cilët trajnimin themelor e filluan me 12.07.2022 në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Kjo gjeneratë do të përbehet

nga 462 kadetë policorë. Nënshkrimi i kontratave bëhet pas përfundimit të të gjitha fazave të testimeve, ku këtë konkurs e bën të veçantë që për herë të parë nga Policia e Kosovës kandidatëve iu është mundësuar aplikimi online në konkursin për zyrtarë policorë dhe po ashtu për herë të parë kandidatët i janë nënshtruar testimit me shkrim online.



20 VJET POLIC I KOSOVËS

Ersan Sunduri nga prilli 2002 i është bashkangjitur Policisë së Kosovës, dhe shërben në detyrën e policit plot 20 vjet

Në Policinë e Kosovës shërbejnë me nder shumë zyrtarë, të cilët me punën e vet i kanë dhënë pasqyrim të denjë institucionit, duke bërë që Policia të jetë e vlerësuar dhe e besueshme ndër vite. Ersan Sunduri nga prilli 2002 i është bashkangjitur Policisë së Kosovës dhe shërben në detyrën e policit plot 20 vjet.

Sunduri doli polic nga gjenerata e 19-të në SHSHPK në Vushtri, ku pas diplomimit në fund të qershorit 2002 filloi punën në Stacionin Policor në Prizren.

Si çdo fëmijë që ëndërron për të ardhmen e sidomos për profesionin, ëndërr e tij ishte uniforma dhe ai e ndoqi ëndrrën e tij, duke qenë i vendosur në synimet e tij.

Ai ka ndarë me ne përvojat përgjatë rrugëtimit në Polici që nga fillimi e deri tani duke na treguar se në fillim kishin shumë sfida e duke e përmendur sa sfidues ishte procesi i rekrutimit: "Isha 23 vjeçar dhe konkurrenca ishte e madhe, duhet të jepnim më të mirën për të qenë pjesë e PK-së, pastaj pas diplomimit u caktuam nëpër stacione policore me detyrë dhe kjo ishte një sfidë e re si zbatues i ligjit por se me ndihmën e kolegëve më me përvojë, e cila nuk mungonte asnjëherë, ishte e përbalueshme çdo situatë e panjohur dhe me kalimin e kohës u mishëruam me këtë profesion.

Hera e parë kur dola me uniformë

ishte emocion i papërshkrueshëm, isha i lumtur që më në fund ia dola ta realizoja ëndrrën, t'i shërbeja të mirës dhe ta luftoja të keqen. Njëkohësisht ndjeja edhe një përgjegjësi të madhe mbi supet e mia por se me vullnet pasiguria ime u kthye në forcë dhe besim për ta kryer detyrën me ndershmëri dhe me përgjegjësi të plotë.

Puna e zyrtarit policor është ndër detyrat më të vështira por edhe më fisnike".

Rreshter Ersani shkollën fillore dhe të mesme e ka përfunduar në Prizren, ndërsa ka studiuar në gjuhë angleze në SHLP "Xhevdet Doda" po ashtu në Prizren, si dhe në fakultetin juridik në UPZ "Ukshin Hoti" ku edhe mori titullin баçелор.

Flet, kupton dhe shkruan 4 gjuhë: shqip, serbisht, turqisht dhe anglisht.

Gjatë 20 viteve shërbim në PK, Ersani ka kontribuar në njësi të ndryshme gjë që e ka kalitur shumë profesionalisht duke e bërë më të afërt me profesionin. Në vitin 2013 është graduar në gradën rreshter, ndërsa në vitin 2012 është dekoruar me medaljen për shërbim të besnikërisë. Gjatë punës ai ka pranuar mirënjohje të ndryshme, si nga shërbimi ashtu edhe nga organizata të ndryshme për punën e mirë dhe detyrat e kryera me përkushtim.

Gjatë kësaj periudhe mbi 20 vjeçare Sunduri ka kryer edhe trajnime të shumta, ndër to trajnimi për hetimet kriminale, trajnimet e inteligjencës dhe



analizës, menaxhimi i aksidenteve, trajnimin menaxhimi i vijës së parë etj. Krahas punës rreshteri rëndësi të veçantë i kushton edhe familjes. Ai është i martuar dhe është baba i 3 fëmijëve.

Mesazhi i tij si polic që shërben 20 vjet në shtetin e Kosovës ku thotë: "Jemi duke kryer një detyrë të shenjtë dhe duhet të japim më të mirën tonë me qëllim që t'u sigurojmë një ambient të qetë dhe të sigurt qytetarëve të Republikës së Kosovës në përgjithësi, e sidomos fëmijëve tanë, brezave të ri në veçanti, përderisa edhe porosit që të vazhdohet angazhimi për përmirësimin e kushteve të punës, si dhe të punohet shumë në sensibilizimin e qytetarëve për bashkëpunim edhe më të madh". Rreshteri gjatë kohës në PK nuk ka pasur asnjë shkelje disiplinore dhe ka treguar performancë të lartë në kryerjen e detyrave të caktuara, si pjesëtar i PK-së.

Dy dekada shërbim janë pjesë e çmueshme e jetës, janë vite të arta të një e shumë të rinjve të cilat ja falën shërbimit në Polici dhe është krenari të flasim e të shkruajmë për ata që e duan duke e mbrojtur vendin, shtetin tonë të çmueshëm.

Përgatiti: Merita Canolli - Gashi

Trajnime të rëndësishme për zhvillimin e kapaciteteve policore, ngritjen e njohurive dhe aftësive mbi kategorizimin e armëve, eksplozivëve dhe prekursorëve të tyre



Trajnime të rëndësishme për zhvillimin e kapaciteteve policore, ngritjen e njohurive dhe aftësive mbi kategorizimin e armëve, eksplozivëve dhe prekursorëve të tyre

Në vazhden e trajnimit dhe avancimit të njohurive profesionale për pjesëtarët e Policisë së Kosovës këtë vit është realizuar trajnimi i 7-të pesëditor për 40 zyrtarë të zbatimit të ligjit për mbledhjen e informacionit, analizën, ndarjen, kategorizimin e armëve, eksplozivëve,

policimin në komunitet dhe policimin e udhëhequr nga intelijenca.

Gjithsej 400 zyrtarë nga Policimi në Bashkësi, zyrtarë patrullimi, zyrtarë të Policisë Kufitare dhe analistë nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut morën pjesë në këto trajnime të përshtatura për zhvillimin e kapaciteteve, ku zgjeruan njohuritë dhe aftësitë e tyre mbi kategorizimin e armëve, instrumentet ligjore dhe Kornizën drejt Armëve të Vogla dhe Kontrollin e Armëve

të Lehta (SALW), eksplozivëve dhe prekursorëve të tyre, në përputhje me standardet e policimit në bashkësi duke kontribuar në Policimin e Udhëhequr nga Intelijenca.

Trajnimet u organizuan në kuadër të projektit për Qasjen e Integruar Institucionale Ndërkufitare drejt Luftimit të Trafikimit të Paligjshëm të armëve (IAT) dhe AVL-ve, të zbatuar bashkërisht nga UNDP-ja në Kosovë dhe UNDP-ja e Maqedonisë së Veriut, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Brendshme nga të dy vendet. Projekti është financuar përmes fondit "MPTF" nga Republika Federale e Gjermanisë, Mbretëria e Bashkuar, Suedia, Franca, Holanda dhe Norvegjia me mbështetjen e Bashkimi Evropian.



Bashkëpunimi ndërmjet akterëve vendorë dhe ndërkombëtarë, OJQ-ve dhe qytetarëve, në inicimin e strategjisë për marrëdhënie me publikun



Bashkëpunimi i Policisë së Kosovës me qytetarë, media, institucione vendore dhe ndërkombëtare, OJQ, bashkësi fetare dhe të gjitha palët tjera të interesit në fushën e marrëdhënieve me publikun është objektiv kyç i Policisë së Kosovës dhe bëhet nëpërmjet të gjithë strukturës organizative të Policisë së Kosovës. Komunikimi dhe bashkëpunimi me publikun janë vendimtar për ndërtimin e marrëdhënieve të mira dhe partneritetit me qytetarët me qëllim të një shërbimi sa më cilësor nga Policia e Kosovës. Me qëllim të avancimit të

këtij bashkëpunimi, Policia e Kosovës, e mbështetur nga misioni i OSBE-së në Kosovë, është duke zhvilluar strategjinë e saj për Marrëdhënie me Publikun dhe Planin e Veprimit 2023-2026, të identifikuar si nevojë në Planin Zhvillimor Strategjik të PK-së 2021-2025. Anëtarët e grupit punues nga PK, MPB dhe partnerët si OSBE, ICITAP, Projekti për Përkrahjen e Reformës në PK, gjatë punëtorisë dy ditore theksuan rëndësinë e një qasjeje proaktive në komunikim me publikun, që pritet të mbështesë PK-në, në përmirësimin e një kuptimi më të

mirë dhe të nevojave për informacion të komunitetit dhe demonstrimin e proaktivitetit në adresimin e tyre. Dokumenti mbulon një sërë nevojash, si forcimi i komunikimit të brendshëm, avancimi i marrëdhënieve me publikun dhe komunikimin proaktiv me publikun. Zbatimi i Strategjisë do të ketë shtrirje në të gjitha fushëveprimet e Policisë si dhe do të kontribuojë në ruajtjen e besimit të publikut dhe efikasitetit të përgjithshëm të organizatës policore.

Përgatiti: Luljeta Mehmeti-Quigley





Fëmijët, e ardhmja e Policisë së Kosovës

Policia e Kosovës, si gjithnjë i mbështet dhe i gëzon fëmijët me aktivitete dhe realizim kërkesash për ta.

Edhe këtë vit Policia e Kosovës, duke u bazuar në projektin e Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Parandalim, në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës dhe Federatën e Basketbollit të Kosovës, me rastin e 1 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, në sheshin “Skënderbeu” në Prishtinë, organizuan disa aktivitete të përbashkëta për nder të kësaj dite.

Pjesë e këtyre aktiviteteve ishte edhe prezantimi i disa njësive policore si dhe

organizimi i lojës së basketbollit për femra dhe meshkuj në mes të Policisë së Kosovës dhe Federatës së Basketbollit.

Për të përkrahur dhe mbështetur këto aktivitete dhe për t’ua uruar festën fëmijëve, morën pjesë: ministri i Punëve të Brendshme, z. Xhelal Sveçla, kryetari i Komunës së Prishtinës z. Përparim Rama, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, z. Samedin Mehmeti, presidenti Komitetit Olimpik të Kosovës, z. Ismet Krasniqi dhe kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës, z. Arben Fetahu, të cilët ndanë kupën dhe medalje për pjesëmarrësit. Pjesëmarrësit për të cilët u

organizua festa-fëmijët, shprehën shumë mirënjohje dhe gëzim. Ata u mrekulluan duke e parë forcën e Policisë dhe shumë prej tyre na treguan se sa të sigurt ndjehen kur në vendin e tyre ka kaq shumë mbrojtje dhe se ndjehen të lumtur për gatishmërinë e tyre për t’i mbrojtur në çdo rrezik që hasin.

Disa na treguan se pëlqejnë që profesionin e tyre në të ardhmen të jetë POLIC i Kosovës.

Është kënaqësi të shërbesh për buzëqeshjen e tyre plot jetë!

Përgatiti: Merita Canolli - Gashi





NJËSITET ELITE TË POLICISË SË KOSOVËS, ÇDO DITË E MË TË FORTA DHE MË PROFESIONALE

Policia e Kosovës, në kuadër të vetin ka një numër të madh të njësive të profesionalizuara, përfshirë edhe njësitë elite të saj. Në kampin e Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës në Vrellë, u mbajt ceremonia e certifikimit të zyrtarëve të njësiveve elite të Policisë së Kosovës, përkatësisht Njësitit Special Intervenues (NJSI) dhe Njësisë Speciale Operative (NJSO).

Kjo ceremoni u realizua pas një trajnimi profesional mjaft sfidues për zyrtarët policorë, por edhe motivues për të gjithë ata që arritën sot ditën e certifikimit, përfshirë edhe certifikimin e instruktorëve trajnues.





UNDP-ja ME DONACION PËR POLICINË E KOSOVËS, NDIHMESE PËR KONTROLL MË TË MIRË TË ARMËVE

Mjetet dhe pajisjet e ofruara për PK-në në këtë rast përfshijnë pajisje profesionale si: skanerë dore, kamera termike, endoskopë dhe dronë, të cilët PK-ja do t'i përdorë për të luftuar trafikun e armëve të paligjshme dhe përmirësimin e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta. Ky financim është përkrahur/financuar nga Gjermania, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Suedia, Holanda, Norvegjia me mbështetje edhe nga Bashkimi Evropian.



'Veprimi i shpejtë' – Ushtrim i përbashkët



Policia e Kosovës dhe EULEX-i, gjatë këtij viti në kampin 'Vrella', mbajtën një ushtrim fushor i cili u përcoll nga afër, nga përfaqësues të lartë nga Ministria e Punëve të Brendshme, stafi i lartë menaxhues i Policisë së Kosovës, kryesuesi i misionit të EULEX-it, si dhe përfaqësues nga KFOR-i, të cilët ishin në cilësi të vëzhgueseve.

Përmes këtij ushtrimi fushor të quajtur 'Veprimi i shpejtë', Policia e Kosovës me zyrtarët e saj të njësive speciale dhe të rendit publik dhe ato të njësive speciale nga EULEX-i, demonstruan aftësitë dhe shkathtësitë e tyre profesionale, në bashkërendim dhe komunikim të ndërsjellë, në rast të intervenimit dhe menaxhimit me situata të ndryshme në nivel vendi.

Duke realizuar trajnime dhe ushtrime të përbashkëta në nivele të ndryshme, po dëshmohet angazhimi dhe përkushtimi për të qenë profesional në veprimet e përbashkëta, të cilat kanë për qëllim ruajtjen e rendit publik, ofrimin e sigurisë ndaj vendit dhe qytetarëve pa dallime.



Pushor i Policisë së Kosovës dhe EULEX-it



Operacione

Policia e Kosovës sekuestron rreth 93 kg substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë



Policia e Kosovës konkretisht Njësia për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë – Prizren, bazuar në informacionet e pranuar dhe punës operative disa mujore në terren, me datën 03.06.2022 ka zbatuar planin operativ të koduar “Dardha”, me ç’rast në fshatin Tupec - Prizren është ndaluar një automjet i tipit Mercedes, me targa vendore, me drejtues mashkull shtetas i Shqipërisë, i cili në tentativë për t’u arratisur në këmbë, është arrestuar nga zyrtarët policorë. Pas arrestimit të të dyshuarit të lartcekur është bërë kontrollimi i automjetit, me ç’rast janë vërejtur disa thasë me substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë.

Në vazhdim të zhvillimit të këtij operacioni policor është bërë edhe arrestimi i personit të dytë të dyshuar mashkull shtetas i Shqipërisë, i cili dyshohet se me një automjet të tipit Audi me targa të Shqipërisë ia ka siguruar rrugën për lëvizje të dyshuarit të parë i cili po lëvizte me automjetin me narkotikë.

Gjatë zhvillimit të procedurave lidhur me rastin janë gjetur dhe janë sekuestruar:

- njëqind e tetëdhjetë e një (181) paketime me substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë, me peshë 93 kilogramë e 249 gramë.
- një peshore.
- gjashtëqind e njëzet e dy (622) euro.
- gjashtëmijë e shtatëqind (6700) lekë të Shqipërisë.
- dy automjetet e përfshira në rast.

Pas marrjes së urdhrat verbal nga gjyqtari i procedurës paraprake në Prizren, është kontrolluar edhe depoja e cila ishte nën shfrytëzim të personave të dyshuar, ku dhe janë vërejtur mallra të ndryshme

që dyshohet se janë të kontrabanduara. Me këtë rast janë njoftuar zyrtarët kompetentë nga Dogana e Kosovës, të cilët janë duke u marrë me procedurat e mëtuftjeshme.

Lidhur me rastin po ashtu është konfiskuar edhe një automjet tjetër i tipit Mercedes me targa të Shqipërisë, i cili ishte në afërsi të depos, nën shfrytëzim të personave të dyshuar.

Me vendim të prokurorit të shtetit pas intervistimit të personave të dyshuar në prezencë të avokatëve, të njëjtit janë ndaluar për 48 orë.

Aksioni i policisë rajonale rreth shkollave në Ferizaj



Drejtorja Rajonale e Policisë në Ferizaj, përkatësisht Sektori Rajonal i Hetimeve në koordinim me Drejtorinë e Arsimit të komunës së Ferizajt dhe nën autorizim të Prokurorisë Themelore ët Ferizajt, mbi bazën e disa informacioneve që ka pranuar rreth dukurive negative të nxënësve dhe personave tjerë në shkolla dhe përreth tyre, që në fillim të muajit shkurt 2022 kishte nisur një aksion i koduar “Siguria në shkolla 2022”.

Në kuadër të këtij plani, pas disa kontrolleve të zhvilluara nga hetues rajonal me rroba civile, të mbështetur edhe nga njësi tjera, kanë ndaluar dhe kontrolluar shumë nxënës në afërsi të shkollave, dhe persona tjerë në rrugë të ndryshme të qytetit. Gjithashtu, janë bastisur dhe kontrolluar disa lokale, shtëpi dhe objekte përcjellëse, ku si prova materiale janë gjetur dhe janë konfiskuar:

- armë zjarri (pistoleta), pesë (5).
- armë të gjata gjysmë automatike dy (2),

- sasi e municionit,
- thika, 40 copa, kryesisht të nxënësve të shkollave të mesme,
- boksa metali, 10 copë, të nxënësve të shkollave të mesme,
- mulli për bluarje të marihuanës 6 copë,
- shufra metali, 4 copë,
- elektro shok, 1 copë.

Ndërsa janë ndaluar dhe janë shoqëruar në Polici dyzetë (40) persona, me dyshimin se kanë përdorur narkotikë dhe ndaj tyre janë iniciuar raste në Prokurorinë dhe Gjykatën Themelore të Ferizajt.

Gjithashtu janë ndaluar dhe janë shoqëruar në Polici edhe njëzetë (20) persona, nën dyshimin se kanë shitur narkotikë (marihuanë) dhe ndaj tyre janë iniciuar raste penale për Prokurorinë Themelore të Ferizajt.

Aksioni i Policisë pritet të vazhdojë edhe në etapat tjera, gjatë shtatorit 2022, me fillimin e procesit të mësimi, me synim parandalimin dhe luftimin e dukurive negative rreth dhe nëpër shkolla.

Policia e Kosovës gjatë një operacioni policor sekuestron rreth 18 kg marihuanë



Policia e Kosovës, konkretisht Drejtorja për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë – DHTN, pas informacioneve të pranuar përmes rrugëve operative në terren, me datën 01.06.2022 në rrotullimin hyrje-dalje në autostradë Prizren-Veri ka ndaluar dy vetura të dyshuara, ku gjatë kontrollimit të tyre janë gjetur : 1 qese e plastikës, 1 valixhe me 36 paketime substancë të dyshuar narkotike të llojit marihuanë, me peshë gjithsej rreth 18 kg.

Gjatë zhvillimit të operacionit në cilësi të provave materiale janë sekuestruar:

- 1 veturë e tipit Renault me targa vendore,
- 1 veturë e tipit Audi me targa vendore,
- 2 telefona mobilë, si dhe prova të tjera materiale që ndërlidhen me rastin.

Në lidhje me rastin është njoftuar prokurori kompetent dhe me urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake janë kontrolluar shtëpitë dhe objektet përcjellëse të personave të dyshuar, ku gjatë kontrollimit të tyre nuk është gjetur asgjë e dyshimtë.

Me vendim mbi ndalimin e personave, dy të dyshuarve meshkuj/kosovarë u është caktuar masa e ndalimit, ndërsa një person tjetër i dyshuar mashkull/kosovar gjendet në arrati.

Të gjitha dëshmitë lidhur me rastin janë fotografuar dhe janë tërhequr nga Njësia e Krim Teknikës ndërsa rasti vazhdon të hetohet nga njësitet kompetente policore.

Policia e Kosovës, në luftë me kontrabanduesit e mallrave



Policia e Kosovës, respektivisht njësia policore nga Drejtoria Rajonale e Policisë Kufitare – Lindje, në zbatim të masave për parandalimin dhe luftimin e paligjshmërisë dhe kontrabandës kanë intensifikuar kontrollet taktike dhe operacionale në terren.

Me datën 21.06.2022 rreth orës 00:10, njësia e taskforcës nga drejtoria e lartcekur, gjatë kryerjes së detyrave të rregullta dhe vëzhgimit, në pritë të befasishme, ka arritur të vërejë dhe të përcjellë hyrjen e disa mallrave përmes rrugëve malore ilegale nga Serbia në Kosovë, me ç'rast ka arritur të parandalojnë kontrabandimin me mallra, ku si rrjedhojë janë kapur mallra të ndryshme, si pije alkoolike, mish i bluar, pjesë të automjeteve, fletore

etj.


Njësia e Policisë Kufitare me mbështetjen e Hetimeve Rajonale dhe në bashkëpunim me prokurorinë e shtetit, janë duke punuar intensivisht për hetimin e rastit si dhe parandalimin e rasteve të tilla, ndërsa malli i konfiskuar i dorëzohet Doganës së Kosovës për procedura të mëtejme.

Policia Kufitare parandalon një rast të tentativës për kontrabandë, sekuestrohen mbi 600 (gjashtëqind) kilogramë duhan i papërpunuar



Policia e Kosovës, gjegjësisht Drejtoria Rajonale e Kufirit – Lindje, me njësitet patrulluese policore për mbikëqyrje kufitare, në zbatim të masave për parandalimin dhe luftimin e paligjshmërisë dhe kontrabandës, kanë intensifikuar në vazhdimësi kontrollet taktike dhe operacionale në terren.

Si rezultat i kësaj, me datën 05.05.2022, në orët e mbrëmjes, bazuar edhe në analizën e riskut dhe informacioneve inteligjente të bëra nga ana e njësive të Policisë Kufitare është arritur të identifikohen katër (4)



kuaj të cilët ishin futur në territorin e Republikës së Kosovës nga Republika e Maqedonisë Veriore, dyshohet përmes rrugëve ilegale, të cilët ishin të ngarkuar me duhan të papërpunuar.

Duke u bazuar në informacione inteligjente, ngarkesa së bashku me kafshët-kuajt, kishin pasur destinacion shtëpinë e personit të dyshuar Z. N., në fshatin Lubishtë, Komuna e Vitisë, me qëllim të ri-ngarkesës në një automjet me targa vendore.

Pas konsultimeve me prokurorin kompetent, është bastisur edhe shtëpia e pabanuar, me ç'rast në një nga hapësirat e saj, janë gjetur edhe një sasi e konsiderueshme e mallit të njëjtë - duhan i papërpunuar. Në total janë gjetur 34 thasë duhan 'refuz' të papërpunuar mbi 500 (pesëqind) kilogramë dhe 94 (nëntëdhjetë e katër) paketime duhan (rreth 1 kg.) e që bën rreth 94 kg. në total. Pas hetimeve preliminare në bashkëpunim me prokurorinë përkatëse, malli-duhani i konfiskuar do t'i dorëzohet Doganës së Kosovës për veprime të mëtejme ligjore.



POLICIA E KOSOVËS, VAZHD NGRITJEN DHE FORCIMIN E BA

Përgatiti: Çajup Kajtazi

Policia e Kosovës, përmes zyrave për informim, ka qenë vazhdimisht e përkushtuar në ngritjen dhe forcimin e bashkëpunimit me publikun, mediumet elektronike dhe të shkruara, me qëllim të rritjes së transparencës për veprimet policore. Gjithashtu ka mbështetur dhe ka promovuar disa fushata sensibilizuese në interes të përgjithshëm shoqëror, me theks të veçantë në fushën e sigurisë rrugore, kundër përdorimit të drogave etj.

Duke marrë në konsideratë faktin se Policia e Kosovës udhëhiqet nga parimi i policimit demokratik dhe si rrjedhojë e kësaj transparencë para shoqërisë dhe publikut në përgjithësi është esenciale për funksionimin e Policisë, gjatë kësaj periudhe faqja zyrtare e Policisë së Kosovës në rrjetin social 'Facebook' <https://facebook.com/Kosovopolic/> ka gjithsej 130,5 mijë ndjekjes aktiv, prej tyre 80,3% janë meshkuj ndërsa 19,7% femra.

Ndërsa sa i përket shkrimeve më të lexuara dhe duke u bazuar në statistika zyrtare të rrjeteve sociale si Facebook dhe Twitter, padyshim se rol të rëndësishëm kanë pasur shkrimet që ndërlidhen me sigurinë rrugore, publikime të ndryshme të natyrave të ndryshme për vitin 2021, duke u bazuar në numrin e shikueshmërisë del se lajmi i datës 14 dhjetor 2021 'Identifikohet dhe ndëshkohet personi



i cili ka përdorur drita rotative në automjetin e tij', ka shënuar numrin prej 639.2 mijë shikimeve, pastaj njoftimi për konkursin për policë të rinj ka shënuar 311 mijë shikime, pastaj kërkesa për bashkëpunim në identifikimin e një të dyshuari për 'vrasje të rëndë' ka shënuar 267,3 mijë shikime, e kështu me radhë.

PUBLIKIMET GJATË VITIT 2021

- 1.) janë lëshuar 1633 komunikata me shkrim për media;
- 2.) janë publikuar 365 raporte 24-orëshe;

3.) janë publikuar 17746 raporte të shpejta në Intranet nga Qendra Operative;

4.) janë publikuar 1619 aktivitete të ndryshme policore në rrjetet sociale të Policisë;

5.) janë publikuar 365 statistikave të përgjithshme të publikuara në web dhe rrjetet sociale;

6.) janë dizajnuar dhe janë publikuar 86 projekte policore;

7.) janë publikuar 61 publikime të natyrës së ndryshme duke përfshirë, rregullore, parime, procedura, njoftime në web faqe dhe në Intranet të PK-së;

8.) janë publikuar 153 konkurse të brendshme në Intranet;

9.) janë publikuar videospote, broshura të ndryshme në kanalin zyrtar të PK-së në youtube dhe gjithashtu janë publikuar broshura vetëdijesuese, është dizajnuar dhe publikuar fushata sensibilizuese në lidhje me aplikimin për zyrtarë policorë.

PUBLIKIMET E NDARA - JANAR – DHJETOR 2021 KRAHASUAR ME 2020 -tën

	Komunikat at e ZIMP dhe rajonet të publikuara në web dhe Intranet	Raporti 24 ore i publikua r në Intranet:	Raportet e shpejta në Intranet:	Statistikat e përgjiths hme të publikuar a në web dhe rrjetet sociale:	Publikimi i aktivitetev e në rrjetet sociale në fbc dhe twitter:	Dizajni me të ndrysh me policore:	Publiki me në web faqe dhe në Intranet :	Konkurs et e brendsh me:
2021	1633	365	17746	365	1619	86	61	153
2020	815	365	15555	365	1148	45	108	100
Përqindja	+50.01	/	+12.34%	/	+29.10%	+47.64%	-77%	+34%

Sqarim:

Rritja e publikimit të postimeve në rrjete sociale është rreth 30%, ndërsa e komunikatave mbi 50%.

IMISHT E PËRKUSHTUAR NË SHKËPUNIMIT ME PUBLIKUN

RANGLISTA E FAQEVE ZYRTARE TË FACEBOOK, E RENDITUR NGA VETË KOMPANIA FACEBOOK PËR FAQE ZYRTARE TË INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS

Faqja zyrtare në Facebook e PK-së është renditur e para për nga shikimet, gjithashtu është e pëlqyer me mbi 65.1K në këtë vit, krahasuar me vitin paraprak i cili ka qenë rreth 64 K.


Sqarim: Falë punës, angazhimit dhe publikimeve gjatë 24 orëve, 7 ditë në javë nga zyra e mediave, faqja e PK-së qëndron e para në nivel vendi si më e vizituara dhe më e pëlqyera nga qytetarët/ndjekësit. Duhet ditur se asnjëherë nuk është bërë ndonjë sponsorizim apo boost për rritje të pëlqimeve.



(Grafikoni i cili paraqet në vazhdimësi që faqja në Facebook e PK-së është në rritje)



(Grafikoni i cili paraqet shkrimin me të shikuar dhe komentuar për vitin 2021 në rrjetin social ne Facebook)



(Grafikoni i cili paraqet shikueshmërinë sipas qyteteve dhe shteteve për vitin 2021 në rrjetin social ne Facebook)

Shiko Faqet					
Reagimet, komentet dhe shpërndarjet					
Faqe		Pëlqimet e faqes n	Nga java e kaluar	Posts This Week	Engagement This Week
1	Kosovo Police	65,1K	▲ 100%	39	72,5K
2	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	48,4K	▲ 100%	0	19
3	Ministria e Financave	47,2K	▲ 100%	2	3,2K
4	Administrata Tatimore e Kosovës	33,7K	▲ 100%	4	4K
5	Ministria e Punëve të Brendshme	32,4K	▲ 100%	1	361
6	Dogana e Kosovës	22,9K	▲ 100%	1	350

(Grafikoni i cili paraqet faqen zyrtare të PK-se si me të lexuar nga 6 faqet e paraqitura nga institucionet për vitin 2021 në rrjetin social ne Facebook)

Siguria në shkolla, ndër angazhimet kryesore të Policisë së Kosovës

Policia e Kosovës, si institucion i ruajtjes së rendit dhe zbatimit të ligjit, synon realizimin e të gjitha objektivave të saja me profesionalizëm për krijim të një ambienti sa më të sigurt për të gjithë qytetarët.

Policia e Kosovës ndaj kategorive të caktuara të cilat konsiderohen si më të ndjeshme sa i përket qasjes ndaj rrezikut, ndërmerr veprime të shtuara në veçanti në hapësirat dhe objektet që frekuentohen nga një masë më e gjerë, ku mund të lulëzojnë forma të ndryshme të kriminalitetit dhe dukurive negative.

Në mesin e shumë institucioneve me të cilat Policia e Kosovës ka bashkëpunim janë edhe institucionet arsimore ndaj të cilave PK-ja kushton vëmendje të veçantë, duke u koordinuar dhe bashkëpunuar për aranzhimin e aktiviteteve të ndryshme policore që kanë për qëllim vetëdijësimin përmes informimit të formave të mundshme të cenimit të sigurisë dhe mbarëvajtjes së proceseve mësimore.

Në kuadër të PK-së ekziston edhe Njësia për Parandalimin e Delikuencës

së të Miturve, e cila trajton në mënyrë specifike rastet e raportuara në shkolla dhe përreth tyre. Planet operative të hartuara vihen në zbatim nga zyrtarët kompetentë, të cilët të uniformuar apo edhe në rroba civile me prezencën e tyre identifikojnë personat problematikë, llojet e veprave penale që kryhen nëpër shkolla por edhe parandalon aktivitete të ndryshme që vejnë në pikëpyetje sigurinë e nxënësve në shkolla.

Përveç planeve operative, Policia e Kosovës në koordinim me stafin e shkollave organizon në grupmosha të caktuara ligjërata sensibilizuese, në të cilat bëhet vetëdijësimi i nxënësve rreth rëndësisë së raportimit të rasteve të dyshimta, personave të dyshimtë që mund të jenë potencialisht të rrezikshëm, substancave të dyshuara dhe pasojave që mund të shkaktohen nga përdorimi i tyre, ofrimi i njohurive mbi rregullat e komunikacionit rrugor dhe respektimi i shenjave të komunikacionit.

Përgatiti:

Arlinda Rexhepi - Gërzhaliu

POLICI I KOSOVËS

I paepur për shtet
I paepur për atdhe
I paepur në detyrë
Jam polic
Rojtar i vendit tim
I palëkundur
I papërkulur
Në luftë kundër territ
I bekuar jam
Polic Kosove më thonë
Me emblemë në uniformë
Jam i edukuar
Për komb e atdhe
E bëj vdekjen
Si me le



Info.

Numrat e Stacioneve Policore

Rajoni i Prishtinës

Drejtoria Regionale Prishtinë	038/ 540 021
Trafiku Rajonal Prishtinë	038/ 534 234
Stacioni Policor Obiliq	038/ 561 600
Stacioni Policor Fushë Kosova	038/ 535 812
Stacioni Policor Graçanica	038/ 564 292
Stacioni Policor Lipjan	038/ 581 010
N/Stacioni Policor Drenas	038/ 584 092
Stacioni Policor Podujevë	038/ 571 805
Stacioni Policor Veriu	038/ 249 942
Stacioni Policor Jugu	038/ 549 924
Stacioni Policor Qendra	038/ 502 223
N/Stacioni Policor Orllan	038/ 614 972
N/Stacioni Policor Bërnice	038/ 515 092
N/Stacioni Policor Magure	038/ 502 472
Nenstacioni Policor Janjevë	038/ 567 009

Rajoni i Pejës

Drejtoria Regionale Pejë	039/ 432 327
Stacioni Policor Pejë	039/ 433 273
Trafiku Rajonal Pejë	039/ 432 595
Stacioni Policor Istog	039/ 451 374
Stacioni Policor Klinë	039/ 471 199
Stacioni Policor Deçan	039/ 361 020
Nën Stacioni Policor Junik	039/ 370 092
Nën Stacioni Policor Vitomiricë	039/ 442 203
Nën Stacioni Policor Ponasheve	039/ 370 888

Rajoni i Gjakovës

Drejtoria Regionale Gjakovë	038/ 504 504
Trafiku Rajonal Gjakovë	039/ 323 784
Stacioni Policor Gjakovë	039/ 322 482
Stacioni Policor Rahovec	029/ 277 913
Stacioni Policor Malishevë	038/ 269 007

Rajoni i Mitrovicës - Jugu

Drejtoria Regionale Mitrovicë	028/ 532 366
Njësia e Trafikut Rajonal Mitrovicë	028/ 532 628
Stacioni Policor Mitrovicë Jugu	028/ 532 585
Stacioni Policor Skenderaj	028/ 582 087
Stacioni Policor Vushtrri	028/ 572 010

Rajoni i Mitrovicës - Veri

Stacioni Policor/Regjioni Mitrovicë Veri	028/ 425 170
Stacioni Policor ZubinPotok	028/ 461 042
Stacioni Policor Zveqan	028/ 665 130
Stacioni Policor Leposaviq	028/ 83 424
Nën Stacioni Policor Prilluzhe	028/ 573 509

Rajoni i Prizrenit

Drejtoria Regionale Prizren	029/ 244 355
Trafiku Regional Prizren	029/ 244 655
Stacioni Policor Suharekë	029/ 271 024
Stacioni Policor Dragash	029/ 281 017
Nënstacioni Policor Sredskë	038/ 502 575
Nënstacioni Policor Mushtisht	029/ 275 105
Nënstacioni Policor Mamushë	029/ 273 453
Nënstacioni Policor Zhur	029/ 625 092

Rajoni i Gjilanit

Drejtoria Regionale Gjilan	0280/ 330 188
Stacioni Policor Gjilan	0280/ 330 061
Trafiku Regional Gjilan	0280/ 330 091
Stacioni Policor Novobërda	038/ 576 092
Stacioni Policor Viti	0280/ 381 513
Stacioni Policor Kamenica	0280/ 372 390
Nënstacioni Policor Kllot	0280/ 381 094
Nënstacioni Policor Ranillug	038/ 504 504
Nënstacioni Policor Zheger	0280/ 386 011
Nënstacioni Policor Pozharan	0280/ 386-269
Nënstacioni Policor Muqiverrë	0280/ 320 197

Rajoni i Ferizajit

Drejtoria Regionale Ferizaj	0290/ 322 406
Stacioni Policor Ferizaj	0290/ 327 412
Trafiku Regional Ferizaj	0290/ 321 899
Stacioni Policor Shtërpçë	0290/ 70092
Stacioni Policor Kaçanik	0290/ 380 834
Stacioni Policor Hani i Elezit	0290/ 385 015
Stacioni Policor Shtime	0290/ 389 008

Policia Kufitare

Stacioni Policor Kufitar ANP 'Adem Jashari'	038/ 594 451
Drejtoria Rajonale Kufitare 'Veri' Lluzhan	038/ 575 622
Drejtoria Rajonale Kufitare 'Lindje' Kaçanik	038/ 290 380
Drejtoria Rajonale 'Perëndimi' Gjakovë	038/ 504 504

KURIOZITETE

16 fakte interesante që nuk i dini për vende të ndryshme të botës

VIJON NGA NUMRI I KALUAR

Egjipti

Kjo është në varësi të përkufizimit që ju i jepni një shteti sovran, por nëse do të bazoheshit në marrjen e pavarësisë për herë të parë, atëherë është Egjipti ai vend i cili e arriti i pari këtë gjë, bazuar në formimin e dinastisë së parë në vitin 3100 para erës sonë.

Kanada

Kanadaja ka mbi 3 milionë liqene dhe 60 për qind e të gjithë liqeneve në botë ndodhen brenda kufijve të saj.

Arabia Saudite

Toka pa lumenj. Tingëllon pak e çuditshme apo jo? Për një vend aq të madh sa Arabia Saudite duhet të ketë të paktën një lloj uji që rrjedh. Por në fakt nuk ka, shumica e ujit të tyre vjen nga shkripëzimi ose rezervuarët nëntokësorë.

Nigeria

Në përgjithësi vendi më i ri në botë përcaktohet duke llogaritur pjesën e popullsisë që është më e vogël se 15. Tashmë është Nigeria që e mban vendin e parë me 49 për qind të popullsisë së saj që nuk kanë arritur ende pubertetin.

India

Njihet si vendi më i ndryshëm në botë në pothuajse çdo kategori, si kulturore, ekonomike, klimatike, racore, gjuhësore, etnike dhe fetare, India është vendi më i ndryshëm në botë.

VIJON NË NUMRIN E RADHËS

Polici ndalon biznesmenin me Lamborghini vetëm për një foto



Ju ka ndalur ndonjëherë Policia në Tiranë për të bërë një foto me makinën tuaj? Mund t'ju duket e çuditshme, por një gjë e tillë ka ndodhur ditën e sotme. Lamborghini është ndaluar në mes të ditës nga këta dy policë dhe siç duket edhe në foto më e bukura qëndron në faktin se ndërsa shoferi përgatitet t'ua japë letrat e makinës dhe lejen e drejtimit, njëri nga policët merr pozën afër makinës e tjetri e shkrep fotografinë për kolegun e tij.

A është vërtet sekret receta e 'Coca-Cola'-s?

Ishte 8 maj 1886, një mbrëmje e nxehtë dhe e lagësht, kur farmacisti John Stith Pemberton në shtëpinë e tij në Atlanta (SHBA), falë edhe përdorimit të një kazanit prej bronzi, zhvilloi recetën e Coca-Cola. Shurupi, i bazuar në ekstrakte bimore dhe arra kola (fara të një peme afrikane), supozohej të përdorej për të trajtuar dhimbjet e kokës. Disa kohë më vonë, farmacisti i Atlantës vuri re se, duke shtuar sode, ilaçi i tij u bë një pije e këndshme dhe shuarëse e etjes. Kështu lindi pija më e famshme në botë, formula sekrete e së cilës ruhet me kujdes edhe sot në një kasafortë të një banke në Atlanta. Versioni i parë i Coca-Cola përmbante gjithashtu një sasi të vogël të substancës narkotike nga bima e

kokainës (kokainë), por në vitin 1903 ajo u hoq plotësisht falë një procedure të ngjashme me atë që përdoret për dekafeinimin e kafesë. Coca-Cola ka lindur si ilaç për dhimbjen e kokës. Gjithmonë ka pasur një atmosferë misterioze për përmbajtjen e pijes së njohur, por së fundmi gazetaria amerikane "Ida Grass" pretendon se ka në posedim librin original të recetave të nënshkruar nga John Pemberton, shpikësi i recetës. Disa nga përbërësit janë: lëng koka, acid citrik, kafeinë, sheqer, ujë, një litër lëng gëlqereje, vanilje dhe po aq karamel sa për të dhënë ngjyrë. Më pas shtohen alkool dhe shije të ndryshme portokalli, limon, arrëmyshk, koriandër, kanellë dhe vaj neroli.

Polici bëhet viral për shkak të ngjashmërisë me aktorin e njohur hollivudian (FOTO)



Një fotografi e një polici nga Alabama është bërë virale në rrjet për shkak të ngjashmërisë së çuditshme me Dwayne 'The Rock' Johnson. Fotografia e postuar në facebook nga Zyra e Sherifit të Qarkut Morgan, Alabama tërhoqi vëmendjen e njerëzve pasi shumë besuan se togeri Eric Fields ishte, në të vërtetë, ylli i Hollivudit. Në një intervistë për The Birmingham News, polici 37-vjeçar tha se njerëzit nuk e krahasojnë vetëm me Johnson por dhe me Vin Diesel.

SIGURIA NË TRAFIK!

POLICIA E KOSOVËS APELON PËR KUJDES TË SHITUAR KËNDREJTOJ MASHINËRITË BUJQËSORE NË RRUGËT

Në vendin tonë çdo vit ndodhin mbi 100 aksidente me mjete motorike
në përshkrahën makineri bujqësore!

ASHKITHARRË	 Mos shpërfaqjeqë në udhëtim të ashpër!	 Mos konsumoni alkool në udhëtim të punës!	 Mos përdor telefon gjatë udhëtimit të punës!	 Mos përdor telefon në udhëtim!
KUR ESHITË E MUNDUR	 Mos parkoni nga nëpër prapësi!	 Prohibicioni mënyrë reflektues!	 Mos parkoni nga të afërta / të dendura!	 Mos parkoni nga afër në rrugë!
GJITHMUNDË	 Mos parkoni nga afër në rrugë!	 Prohibicioni material nëpër rrugë të të afërta / të dendura!	 Prohibicioni i materialit nëpër reflektues!	 Reflektues i gjatë në rrugë!

KUJDESO PËR FAMILJEN TËNDE, QË TË MOS KUJDESEMI NE!

**FAMILJA ËSHËT ATY KU JETA FILLON
DHE DASHURIA KURRË S'MBARON**

Nëse dëshiron ta
ndryshosh botën shiko
në shtëpi dhe duahe
familjen tënde
(Nene Tereza)

**DUAJENI FAMILJEN MBI ÇDO GJË TJETËR. SEPSE,
VETËM ATY JU GJENI PROHTËSINË E VËRTETË**

BARQORTI MOS HIZETO

- 812

- 0800POLICE

- INFO@KOSOVOPOLICE.COM

- INFO@KOSOVOPOLICE.COM "LAJMIQËRI POLICE"

**Ndal Dhunën
në Familje**



MOS NDALO NË AUTOUDHË, NËSE NUK ËSHTË E DOMOSDOSHME!

ÇFARË DUHET BËRË PAS NJË AVARIE/ DEFEKTI TË AUTOMJETIT NË AUTOUDHË!





- Kaloni në shiritin për ndalje emergjente, duke u larguar në skaj të autoudhës
- Edhe nëse të gjithë treguesit janë aktivizuar, mbani vëmendje dikush mund të shkaktojë aksident
- Vendosni trekëndëshin e sigurisë së paku 100 metra prapa mjetit tuaj
- Nëse dilni jashtë mjetit jeni të detyruar ta mbani veshur xelekun reflektues
- Bëhu i vëmendshëm, jeni në një zonë të rrezikshme
- Ndalohet hyrja në autoudhë e automjetit që është duke e tërhequr mjetin në defekt
- Ndalohet lëvizja në shiritin për ndalje emergjente

Kontaktë Policinë e Kosovës:

192

POLICE



[illegible][illegible]